



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/212
Datë: 10.07.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 5 të Ligjit Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat, neneve 10 deri në 22 të Ligjit Nr.08/L-258 për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Autorizohet fillimi i procedurave të tenderimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga era dhe për dhënien e mbështetjes për këto kapacitete deri në 150 megavat. Këto procedura do të zhvillohen në dy procedura tenderimi të ndara.
2. Procedurat e tenderimit të autorizuar nga Qeveria e Republikës sipas pikës 1. të këtij Vendimi, zhvillohen nga Ministria e Ekonomisë sipas Ligjit Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat dhe Ligjit Nr.08/L-258 për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë.
3. Zyra e Rregullatorit për Energji sipas detyrës zyrtare do të shërbejë si anëtar në Komitetin për Partneritete Publiko Privat dhe do të përfaqësohet nga Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së.
4. Ministria e Ekonomisë përfaqëson Autoritetin Kontraktues sipas Ligjit për Partneritet Publiko Privat dhe ka për obligim projektimin, dizajnin dhe zbatimin e procedurave të tenderimit të kapaciteteve gjeneruese në përputhje me ligjet në fuqi dhe vendimet e Komitetit për Partneritete Publiko Privat/KPPP.
5. Ministria e Ekonomisë autorizohet të përfshijë në dokumentacionin e tenderimit, rregullat për trajtimin e ofertave me kapacitet prej 150 megavat apo mund të tejkalojë kapacitetin specifik, në përputhje me praktikën më të mira të industrisë, të vendosura dhe në konsultim me Rregullatorin e Energjisë, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-258 për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë.
6. Të gjitha procedurat e tenderimit do të projektohen në bazë të kriterëve objektive, transparente dhe jo diskriminuese dhe do të zbatohen në përputhje të plotë me dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Partneritet Publiko Privat dhe Ligjit Nr. 08/L-258 për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë